

*“Konsultim publik lidhur me projektligjin 'Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë’”*

*Vlorë, 2 Dhjetor, 2016*

Aktiviteti prezantues i projektligjit u zhvillua në auditorin e Universitetit 'Ismail Qemali', në datën 2 Dhjetor, 2016 ku ishin të pranishëm 69 studentë të drejtësisë, si dhe disa përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizata partnere të Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare.

Fillimisht, u prezantua në detaje drafti nga ekspertja e projektit Mirela P. Bogdani, draft i cili kishte të reflektuar edhe komentet dhe sugjerimet e tryezave të mëparshme të konsultimit publik. Studentët ishin të interesuar të dinin se për cilat çështje mund të paraqitej kërkesë në Parlament apo projekt-ligj; ata u informuan se drafti nuk parashikon kufizime të çështjeve të cilat mund t'i adresohen Parlamentit; kjo është diskutuar edhe më parë nga grupi i ekspertëve dhe është rënë dakord që qytetarët të mos kufizohen në kërkesat e tyre, bazuar edhe tek e drejta e tyre kushtetuese për t'i drejtuar peticione/kërkesa Parlamentit.

Pyetja tjetër lidhej me faktin nëse Parlamenti i Shqipërisë refuzon të miratojë një propozim apo projektligj i cili paraqitet nga shtetasit si nismë e tyre, në respektim të të gjitha procedurave që drafti parashikon, çfarë mund të bëjnë qytetarët që kjo nismë të miratohet; pjesëmarrësit u informuan se Parlamenti ka të drejtën për të gjykuar dhe për të marrë vendim në mënyrë ekskluzive për miratimin ose refuzimin e një nisme; mekanizmi që qytetarët kanë për të adresuar një nismë ligjvënëse është paraqitja e kërkesës apo e një projekt-ligji të plotë në Parlament - nëse Parlamenti e shqyrton në seancë plenare dhe vendos të mos e miratojë draftin, qytetarët nuk kanë asnjë mundësi ankimi apo rishikimi të vendimit të Parlamentit, pasi ky është pushtet diskrecional dhe ushtrimi i vullnetit të tij politik; një sugjerim praktik u evidentua nga ekspertja që nëse nismëtarët janë të vendosur për të miratuar një projektligj, dhe kanë marrë një vendim refuzimi nga Parlamenti, atëherë mund ta paraqesin sërish nismën e tyre në momentin që konstituohet Parlamenti i ri, dhe të fillojnë lobimin me deputetët.

Takimi vijoi me diskutime dhe opinione të studentëve lidhur me nivelin e demokracisë në Shqipëri në raport me shtetet e tjera; në këtë kontekst, ata u njohën nga ekspertja edhe me modelet e ligjeve të shteteve të tjera me të cilat ekspertët e projektit ishin konsultuar për të hartuar projektligjin shqiptar, si dhe me standardet e BE dhe të Këshillit të Evropës lidhur me këto çështje dhe praktika.

Në mbyllje studentët kërkuan mundësitë tjera për të diskutuar sërish për çështje që lidhen me demokracinë, e në mënyrë të veçantë me mekanizmat ligjore që mund të përdorin qytetarët për të pasur rolin e tyre në qeverisje dhe vendimarrjen politike.



*Foto nga Tryeza e Rrumbullakët me temë, “Konsultim publik lidhur me projektligjin ‘Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë’”, organizuar në Vlorë, në ambjentet e Universitetit “Ismail Qemali”, në datën 02 Dhjetor, 2016.*



*Foto nga Tryeza e Rrumbullakët me temë, “Konsultim publik lidhur me projektligjin 'Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë’”, organizuar në Vlorë, në ambjentet e Universitetit “Ismail Qemali”, në datën 02 Dhjetor, 2016.*